



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:038284

Datë: 02.04.2025

Numri i dokumentit: 07075777

C.nr. 284/24

GJYKATA THEMELORE NË P. – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. L. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Filloreta Hoxha - Zymberaj, avokate nga P., kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në P., në adresën rr. ‘N. T.’, pa numër, baza juridike, kontest pune - rrezikshmëria në vendin e punës, vlera e kontestit, 2,112.00 euro, jashtë seancës me datën 02.04.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditëses, F. L. nga P., me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Spitali i Përgjithshëm në P., që në emër të kompensimit për rrezikshmëri në vendin e punës, paditëses t’ia paguaj shumën prej 44 euro x 48 muaj për vitet, 2020, 2021, 2022 dhe 2023, shumën totale prej 2,112.00 euro dhe të OBLIGOHET e paditura Spitali i Përgjithshëm në P., që paditëses t’ia paguaj të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8%, duke i llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së, të cilat do të specifikohen në fjalën përfundimtare, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës se saj, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me bazën juridike, kontest pune - rrezikshmëria në vendin e punës, vlera e kontestit, 1,000 euro, me të cilën ka theksuar se, paditësi është e punësuar tek Spitali i Përgjithshëm në P., me kontratë te punës në afat të pa

caktuar në kryerjen e detyrave të punës si *laborante në shërbimin e biokimisë*. Duke marrë parasysh kohën e nënshkrimit të Kontratës Kolektive Sektoriale, përkatësisht të drejtat dhe detyrimet të cilat burojnë dhe iu njihen të punësuarve sipas kësaj kontrate, respektivisht rrezikshmëria në vendin e punës, ku kjo e drejtë edhe pse të përcaktuar shprehimisht nuk iu ka njohur asnjëherë kategorive të të punësuarve të cilat i mbulon kontrata, prej ditës së nënshkrimit- hyrjes në fuqi të datës 12.06.2018, e gjerë në momentin e parashtrimit të kësaj padie. Ndërsa me parashtrësën e datës 01.04.2024 ka bërë rregullimin dhe precizimin e padisë me të cilën gjykatës i ka propozuar që të marrë aktgjykim dhe të: DETYROHET e paditura Spitali i Përgjithshëm në P., që në emër të kompensimit për rrezikshmëri në vendin e punës, paditëses të ia paguaj shumën prej 44 euro x 48 muaj për vitet, 2020, 2021, 2022 dhe 2023, shumën totale prej 2,112.00 euro. OBLIGOHET e paditura Spitali i Përgjithshëm në P., që paditëses t'ia paguaj të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8%, duke i llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK-së, të cilat do të specifikohen në fjalën përfundimtare, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, e nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigje në padi të dorëzuar në gjykatë me datën 09.11.2024, ka theksuar se, Spitali i përgjithshëm në P., e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, nga se e njëjta nuk i ka bashkangjitur asnjë provë materiale parashtrësës së saj konform nenit 99 par. 3, të LPK-së, për të dëshmuar se paditësja nuk i ka realizuar të drejtat e saj që burojnë nga marrëdhënia e punës, siç pretendon me anë të padisë dhe kërkesës së saj. E paditura me anë të provave materiale dëshmon në çdo kohë se paditësja, F. L. që nga themelimi i marrëdhënies së punës e deri me sot i ka realizuar të drejtat për kushtet e veçanta të punës dhe si rezultat në vendin e punës paditëses i është lejuar të punoje me orar të shkurtuar 7 orë në ditë nga ora 07:00 e deri në orën 14:00, pra duke u liruar nga orari i rregullt i punës një orë më herët, të njëjtës i është njohur edhe rrezikshmëria dhe kompensimi në vendin e punës konform Qarkores së rrezikshmërisë në vendin e punës laborante në shërbimin e biokimisë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që me aktgjykim të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK- së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështjen ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke u nisur nga fakti se, e drejta apo detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është e karakterit absolut, dhe në rrethana të caktuara mund të mos kërkohet mbajtja e një seance publike gjyqësore. Lidhur me këtë aspekt të procedurës, GJEDNJ në rastin *Jussila v. Finland* (Aktgjykimi i dt. 23 nëntor 2006, paragrafi 41), ka përcaktuar se, “Detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është absolut. Pra, ekzistojnë rrethana që nuk kërkojnë mbajtjen e një seance gjyqësore publike, dhe atë p.sh., kur nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestuara mes palëve dhe që determinojnë mbajtjen e një seance gjyqësore, andaj, gjykata mund të vendos në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme lidhur me çështjen në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve tjera të shkruara.” Gjykata duke marr parasysh këtë, vendosjen në këtë mënyrë e bazoj duke i nisur nga natyra jo komplekse e çështjes si dhe duke u bazuar në nenin 399 paragrafi 1 të LPK i cili parasheh se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.*”

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse ishte e punësuar tek e paditura në cilesin e laborante në shërbimin e biokimisë.

Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër të protokollit 163/7 të datës 10.06.2019, e lidhur në mes të Spitalit të Përgjithshëm në P., në cilësi të punëdhënësit dhe F. L.t në cilësi të punëmarrësit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar duke filluar nga data 10.06.2019 dhe gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 507.00 euro, si dhe të drejta dhe detyrat tjera të përcaktuara me këtë kontratë, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Fillimisht, duhet sjellë në vëmendje se Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, në njëri anë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, në anën tjetër, ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, me rastin e nënshkrimit nga ana e palëve. Afati i vlefshmërisë së kësaj Kontrate është 3 (tre) vite, në kuptim të dispozitës nga neni 90 par. 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, në të cilën shprehimisht përcaktohet: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.*”

Bazën juridike të kërkesëpadisë, pala paditëse e ka mbështetur në nenin 9 (nëntë) të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës

së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet rrezikshmëria në vendin e punës dhe konsiderohen: “1.1). Puna në shërbimet e urgjencës dhe emergjencës përfshirë njësit e kujdesit intensiv, 1.2). Puna në mjedise me rrezik jonizuese, 1.3). Puna me të sëmundje ngjitëse të shkallës së lartë dhe materiale infektive përfshirë këtu repartet të cilat nuk janë të caktuara sëmundjet infektive, 1.4). Puna në intervenimet kirurgjike në sallat e operacionit, 1.5). Puna në shërbime psikiatrik dhe shëndetin mental, 1.6). Puna me personat me pengesa te renda ne zhvillimin psikofizik, 1.7). Puna ne kabinetin mjekësor ligjore dhe kabinetin e anatomisë patologjike, 1.8). Puna në laborator me kontaminim kimik, 1.9). Puna në shërbimet e hemo-dializë. Me paragrafin 2 po të këtij neni është përcaktuar se: ‘Punëdhënësi obligohet që të sigurojë të gjitha mjetet dhe masat preventive, me te cilat do të eliminohet rrezikshmëria në vendin e punës. Me paragrafin 3 po të këtij neni është pacaktuar se: ‘punëdhënësi mund të caktoj orar të rregullt prej 30 orësh në javë për punëtorët të cilët përkundër masave mbrojtëse të punës kanë ndikim në shëndetin e tyre.’” Me paragrafin 4 po të këtij neni është përcaktuar se: ‘Të punësuarit të cilët punojnë në vendet e punës të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të kompensohen me pagesë. Përfundimisht, me kërkesë të punësuarit, kompensimi do të bëhet me ditë të lira prej momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate deri me datën 31.12.2028.

Në interpretim të kësaj dispozite të nenit 9 (nëntë) të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 11.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, gjykata ka ardhur në përfundim se e njëjta ka përcaktuar kategoritë, respektivisht shkallën e rrezikshmërisë për të punësuarit në sektorin e Shëndetësisë, ashtu që me paragrafin numër 3 dhe 4 është përcaktuar se “Punëdhënësi mund të caktoj orar të rregullt prej 30 orësh në javë për punëtorët të cilët përkundër masave mbrojtëse të punës kanë ndikim në shëndetin e tyre. Me paragrafin 4 të po këtij neni është përcaktuar se, ‘Të punësuarit të cilët punojnë në vendete e punës të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të kompensohen me pagese. Përfundimisht, me kërkesë të punësuarit, kompensimi do të bëhet me ditë të lira prej momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate deri me datën 31.12.2028’”. Nga interpretimi i kësaj dispozite gjykata ka ardhur në përfundim se punëdhënësi në raport me kërkesën për kompensimin e rrezikshmërisë ka në dispozicion mundësinë që të përmbush të njëjtin në njërën nga dy mënyrat në aspektin alternativ, siç është rregulluar dhe përcaktuar me këtë dispozitë.

Me Ligjin Nr. 04/L-161 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 22, i datës 14 qershor 2013, Prishtinë) për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, është bërë përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë, ky ligj përmban parimet e përgjithshme

për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Me nenin 16 është përcaktuar se *''Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi''*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave, gjykata vlerëson se për t'u konstatuar rrezikshmëria dhe shkalla e rrezikshmërisë në vendin e punës nga punëdhënësi duhet të ketë një vlerësim të shkallës se rrezikshmërisë, në kuptimin e këtyre dispozitave të ligjit përkatëse të cekura si më lartë, gjykata vlerëson se pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të argumentoj se paditësja i është ekspozuar rrezikut në vendin e saj të punës.

Sa i përket kërkesës së paditëses për pagesën e rrezikshmërisë, gjykata gjen se kërkesa e paditëses mbështetet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës të datës 14.10.2008. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklaratë nuk ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyruës për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si një dokument ligjërishit detyruës. Gjkata, duke vlerësuar bazën juridike të kësaj pjese të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas procedurës përkatëse.

Me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 1, i datës 5 Janar 2023, Prishtinë), me nenin 26 shprehimisht është përcaktuar se, *''Shtesa për kushte specifike të punës. Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1, të*

këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për financa”.

Me Rregulloren (QRK) nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, respektivisht me nenin 6 të kësaj rregullore shprehimisht është përcaktuar në kapitullin II: Shtesat për kushtet specifike të punës, “ *Për kushtet specifike të punës është shtesë mujore që përfitohet nga zyrtarët publik dhe të punësuarit e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së shtuar në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. Kategoria pozitive që janë të ekspozuara ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë në mënyrë të shtuar jetën, për të përfituar këtë shtesë mujore, duhet të plotësojnë kriteret si në vijim, hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës, kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës, në secilën situatë, shtesa për kushte specifike të punës nuk mund të përfitohet nga nëpunësit në strukturat përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative të institucioneve përkatëse, procedura për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni, me të dhënat si në vijim: pozitën dhe numrin e të punësuarve në këtë pozitë; përshkrimin e punës të të punësuarit; arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; klasën dhe koeficientin. Kërkesa dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, në këtë përbërje, përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Financa, përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike, Anëtarët e Komisionit janë nëpunës civil, ku njëri nga përfaqësuesit është Kryesues i Komisionit, komisioni është përgjegjës të përpiloj raport përfundimtar në bazë të kërkesave të institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili duhet të përmbaj, lista me pozitat për të cilat kërkohet shtesa e kushteve specifike të punës, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin përkatës për pagat dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje;, vlerën*

indikativë të rekomanduar për secilën kategori potencialisht përfituese të shtesës për kushte specifike të punës, duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, shkaqet për mos përfshirjen e kërkesave të tjera të pranuar në përfitim të shtesës, dhe, informatat tjera që konsiderohen relevante nga Komisioni, me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për Financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar, komisioni, në çdo kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovuar në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj.’’

Nga interpretimi këtyre dispozitave të lartë cekura, si të Ligjit e po ashtu edhe të Rregullores, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e palës paditëse, rezulton të jetë e pa themeltë dhe e pa mbështetur në provat e bashkangjitura padisë, sepse nuk është bashkangjitur asnjë provë që argumenton sa është shkalla e rrezikshmërisë në vendin e punës, pastaj forma dhe mënyra e kompensimit për këtë kategori të shtesave.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palës paditëse, e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si në pikën **I** të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, e lidhur me nenin 463.1 “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”, të LPK-së, si në pikën **II** të dispozitivit të aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin, 143.1 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE P.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

2024:038284, C.nr.284/24, **02.04.2025**

Gj y q t a r i
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.